

KLSH në bashkëpunim me Qëndresa Qytetare organizon workshop-in “Mbi prezantimin e gjetjeve të auditimeve të performancës dhe monitorimin e qeverisë nga Qëndresa Qytetare”.

Më datë 26 janar 2024, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit u organizua workshop-i “Mbi prezantimin e gjetjeve të auditimeve të performancës dhe monitorimin e qeverisë nga Qëndresa Qytetare”.

Në këtë takim morën pjesë audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës si dhe një ekip analistësh të Qëndresës Qytetare.

Organizatat jo qeveritare, grupet e interesit dhe aktorë të tjerë, janë aleatët strategjikë të një Institucioni Suprem Auditimi si KLSH. Departamenti i Auditimit të Performancës ka vendosur ura komunikimi me disa prej tyre dhe bën vazhdimisht përpjekje për t’i zgjeruar dhe thelluar ato sikurse në rastin konkret me Qëndresën Qytetare, ku bashkëpunimi ka qenë i kahershëm çka tregon se ai ka qenë frytdhënës.



Në këtë takim me Qëndresën Qytetare në morinë e temave të auditimit të performancës të realizuara nga departamenti të cilat prekin fusha të ndryshme si arsimit, kultura, bujqësia, mjedisi, përkujdesi social, infrastruktura dhe transporti, zhvillimi ekonomik, shëndetësia, etj., u prezantuan opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimeve të performancës me temë:

1. “Shërbimi i policisë në përgjigje të qytetarëve”, i cili është përqendruar kryesisht tek veprimtaria e strukturave të policisë për ofrimin e një shërbimi cilësor në përbushje të nevojave të qytetarëve.
2. “Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara”, i cili është përqendruar në masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse si dhe të proceseve administrative në garantimin e mirëfunksionimit të sistemit të mbrojtjes, mbështetjes, rehabilitimit dhe parandalimit të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare.
3. “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”, auditimi i cili është fokusuar në politikat dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore në garantimin, miradministrimin dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit.

Gjithashtu në këtë takim nga ana e analistëve të Qëndresës Qytetare u diskutuan analizat dhe monitorimet e tyre lidhur me:

1. “Lulëzimi i pagave në krizën e çmimeve”.
2. “Sfidat e procesit të vetingut në policinë e shtetit”.
3. “Efektet e projektligjit për lojërat e Fatit”.

Në përfundim, pjesëmarrësit diskutuar mbi temat duke vlerësuar maksimalisht bashkëpunimin e deritanishëm si dhe rëndësinë e takimeve të tilla me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira.